

VENDIM
Nr.900, datë 10.11.2010

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE, PËR SHPENZIME KORENTE,
NDËRMJET PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2010, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve, për shpenzime korente, ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si më poshtë vijon:

a) Programit “Tregu i punës”, për vitin 2010, t’i shtohet fondi 40 000 000 (dyzet milionë) lekë.

b) Programit “Mbrojtja sociale”, për vitin 2010, t’i pakësohet fondi 40 000 000 (dyzet milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha